

Vizioni ynë

Nëpërmjet punës sonë ne ndihmojmë njerëzit të përmirësojnë jetesën e tyre. Ne u ofrojmë atyre mundësi për të dalë nga varfëria. Këtë jemi duke e bërë në zonën e Mokrës dhe synojmë ti zgjerojmë projektet tona dhe në vende të tjera të Shqipërisë.

Jeta në komunitet është një aspekt i rëndësishëm në të cilin ne jemi fokusuar. Ne promovojmë ndjenjën e komunitetit si në strukturat lokale ashtu dhe në kishë, duke dalë jashtë kornizave të ndihmës familjare.

Dhuroni për projektet

Për vazhdimësinë e projekteve ne mbështetemi në dhurimet tuaja për ushqim, ilaçe mjekësore, qera, mjete dhe kosto administrative.

• **Behu sponsor projekti:**

Donacionet tuaja janë një kontribut i vlefshëm dhe thelbësor. Në terma afatgjatë, 500, 1.000 ose 5.000 Lekë në muaj kanë një ndikim të madh.

• **Qëndoni të informuar** me të rejtat e fundit dhe publikimet tona përmes www.diakonia.al

• **Bëhu pjesëmarrës** duke marrë pjesë në projektet apo udhëtimet tona misionare. Për më shumë informacion mund të kërkonte online ose të kontaktoni zyrën tonë.

Ju mund të ndihmoni

DA dhe CHW

Fondacioni Diakonia Albania shërben si një organizatë jo-fitimprurëse për njerëzit në nevojë. Ajo na çon pas në kohë, pikërisht në punën shumë-vjeçare të Shoqatës së Krishterë për Ndihmë në Wismar (CHW) Gjermani, e cila në 1992 udhëtoi drejt Pogradecit me ndihmat e para.

Diakonia Albania, e themeluar në vitin 2012 organizon shërbimet dhe projektet në zyrat e Pogradecit dhe Tiranës. Njëkohësisht ne bashkëpunojmë me autoritetet shetërore, me organizata të tjera humanitare dhe me shumë vullnetarë nga Shqipëria, Gjermania dhe shumë vende të tjera.



Fondacioni Diakonia Albania

Rruga Mentor Zavalani
7301 Pogradec
T +355 (0) 83-22 87 51
E info@diakonia.al

Zyra Tiranë:
Rruga 4 Dëshmorët
Nr. 56, Tiranë

www.diakonia.al

NIPT: L21423453S

ProCredit Bank Albania, Ilogaria 5513 3004 0001

IBAN: AL20 2094 2553 0000 5513 3004 0001

Anëtar i Vëllazëria Ungjillore E Shqipërisë (VUSH)



Design: Studio2id.de Foto: Saimir Rakiplari dhe të tjera



PROJEKTE SOCIALE

Ndihmë praktike për njerëzit e varfër në Shqipëri

Në Shqipëri, varfëria ka sjellë vështirësi në shumë familje, veçanërisht në zonat rurale. Përmes projekteve tona, ne sigurojmë për njerëzit në nevojë dhe i ndihmojmë ata të përmirësojnë kushtet e tyre të jetesës.

Ndihma e nevojshme

Situata ekonomike dhe politike e cila karakterizon Shqipërinë vitet e fundit, ka sjellë përkeqësimin e kushteve ekonomike dhe sociale, veçanërisht në zonat e thella të vendit. Mundësitë e pakta dhe largësia gjeografike nuk ka bërë të mundur përmirësimin e situatës së rrugëve, shkollave si dhe institucioneve shëndetësore.

Ne jemi duke punuar në Juglindje të Shqipërisë për rreth 25 vjet. Projektet tona sociale ndihmojnë familjet në nevojë, fëmijët si dhe personat me aftësi të kufizuara. Ata janë një tregues i qartë i mbështetjes sonë dhe kjo është e dukshme për të gjithë zonën.

Shërbimi Komunitar

Zona e Mokrës, pothuajse është e pambuluar me shërbim shëndetësor. Infermieri ynë Bashkim Lilo udhëton çdo javë dhe trajton rreth 40 pacientë në familjet e tyre, duke përfshirë shërbim fizioterapie, përkujdesje për pacientët diabetikë si dhe të sëmurët kronikë. Kjo nënkupton shpenzime të larta për udhëtimet, medikamentet dhe mjetet e tjera ndihmëse.

Ai shoqërohet edhe nga punonjësia sociale Manjola Lushka e cila kujdeset gjithashtu për të moshuarit që jetojnë vetëm në shtëpitë e tyre dhe që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten, udhëzon të afërmit si ti ndihmojnë dhe viziton familjet me problematika sociale.

Përmes projektit tonë një vjeçar në fshatrat e zonës së Mokrës, ne jemi duke u kujdesur për 15 familje ekstremisht të varfëra. Ne i mbështesim çdo muaj me paketa ushqimore dhe ofrojmë trajnime për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Dëshira jonë është që nëpërmjet donacioneve tuaja puna e këtij projekti të vazhdojë dhe të shtrihet në më shumë familje.

Konvikti Bishnicë

Në konviktin tonë ne ofrojmë mundësi arsimimi për fëmijët e të varfëra dhe të largëta. Ata qëndrojnë tek ne nga e hëna në të premte dhe frekuentojnë shkollën publike në Bishnicë. Stafi ynë u ofron atyre këshillim dhe ndihmë mësimore, kurse muzike dhe punë krijuese, mësimdhënie të gjuhëve të huaja. Në këtë mënyrë ne duam të investojmë tek ta për të ndërtuar themele të shëndosha për jetën dhe të ardhmen e tyre.

Njëkohësisht, ne kujdesemi edhe për fëmijët jetimë. Shërbimet tona për fëmijët përfshijnë: ushqim, veshëmbathje, aktivitete në kohën e lirë, materiale shkollore, kujdes higijene, shërbim shëndetësor dhe dentar, këshillim psiko-social, ndihmë në mësim etj. Ne kemi 12 punonjës të cilët kujdesen për rreth 25 fëmijë të qëndrës sonë.



Ushqimi, strehim dhe edukimi për një fëmijë:
20.000 Lekë / muaj



Vizita javore tek një person apo familje:
7.000 Lekë / muaj

Materiale mjekësore dhe higijene:
2.500 – 4.000 Lekë / muaj



Pakot ushqimore:
8.000 Lekë secila
Pako më veshje: 3.000 Lekë
Te tjera: 100.000 Lekë

Ndihma në raste urgjente

Sipas mundësisë ne sigurojmë ndihmë për familjet në raste urgjente si p.sh: rastet e zjarreve, përmytjeve, raste sëmundjesh etj. Përveç pakove familjare dhe donacioneve të tjera ne u ofrojmë edhe kujdes shëndetësor.